

V E N D I M
Nr.528, datë 21.8.1998

PËR PROCEDURAT E TRANSFERIMIT TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË ANONIME
“NPV NR.1”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Transferimin 100 për qind të aksioneve të sh.a. “NPV nr.1” Tiranë tek aksionerët, sipas listës emërore në përfundim të ankandit të datës 31.1.1996.

2. Në kuptimin e këtij vendimi dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.71, datë 2.2.1996 “Për studimin urbanistik pjesor të zonës ndërmjet rrugës së Kavajës, rrugës së re gjatë Lanës, rrugës “Irfan Tomini” dhe rrugës “Muhamet Gjollesha” Tiranë, tërësia e kapitaleve të sh.a. “NPV nr.1” e vlerësuar me shumën 87 442 436 lekë të ndahen si vijon:

- 51 për qind e kapitalit, që i korrespondon vlera 44 595 642 lekë, kalon në pronësi të shtetit;

- 49 për qind e kapitalit që i korrespondon vlera 42 846 794 lekë, kalon në pronësi të sh.a. “NPV nr.1” Tiranë.

3. Urdhri i Ministrit të Financave nr.3, datë 30.11.1995, shfuqizohet.

4. Ankandi i datës 31.1.1996 për transferimin e 49 për qind të aksioneve të shoqërisë anonime “NPV nr.1”, Tiranë në bazë të vullnetit të shprehur nga shteti dhe aksionarët (zotërues të kësaj përqindjeje) anulohet dhe do të shërbejë vetëm për efekt të listës emërore, me vlerat përkatëse të investuara nga secili aksionar.

5. Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe Qendra e Infomatizimit Financiar, në bazë të kapitalit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, të kryejnë rillogaritjet proporcionale të rezultateve për aksionarët e pikës 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano